



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.7/2022

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shukri Sylejmani, kryetar, Beshir Islami dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen disiplinore ndaj Z. E.P., Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga E.Sh., nga Gjilani, kundër vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), nr. 150/2022 datë 20.4.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 6.6.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

Konfirmohet vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr. 150/2022 datë 20.4.2022, ndërsa ankesa e paraqitur nga E.Sh., nga Gjilani kundër këtij vendimi, refuzohet si e pa bazuar.

A r s y e t i m i

Me vendimin e KGJK-së nr. 150/2022 datë 20.4.2022, hedhet si e palejuar ankesa e paraqitur nga E.Sh., nga Gjilani, kundër vendimit të Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës Z. E.P., nr.GJS-2022-005, datë 24.3.2022 me të cilin ishte refuzuar e pa bazuar kërkesa e të lartë përmendurës për iniciimin e procedurës disiplinore kundër R.A., Kryetar i Gjykatës Themelore në Gjilan.

Kundër këtij vendimi të KGJK-ës, me kohë, E.Sh., nga Gjilani, ka paraqitur ankesë me të cilën kundërshton ligjshmërinë e këtij vendimi duke mos dhënë në ankesë propozim të caktuar për mënyrën e vendosjes sipas kësaj ankese.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 15.6. të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, shqyrtoi vendimin e kontestuar të KGJK-së, si dhe shkresat e lëndës, dhe gjeti se:

Ankesa e paraqitur nga E.Sh., nga Gjilani, kundër vendimit të kontestuar të KGJK-ës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se E.Sh., tek Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, ka paraqitur ankesë me propozim për inicimin e procedurës disiplinore kundër Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan z. R.A., me pretendim se i njëjti ka bërë keqpërdorim të pozitës dhe trajtim arbitrar në lidhje me kërkesën e ankueses në këtë rast, që i ka paraqitur kryetarit z. A. për gjyqtarin e çështjes B.S, e që si shkak ka qenë vendimi i kryetarit z. A., AD.GJTH.GJL.nr.03/2022, me të cilin vendim i është refuzuar ankesa e paraqitur nga E. Sh., për inicimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit B.S.. Kryetari i Gjykatës Supreme, me vendimin GJS-2022-005 datë 24.3.2022, ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e E.Sh, për inicimin e procedurës disiplinore kundër z. R.A., Kryetar i Gjykatës Themelore në Gjilan. Kundër këtij vendimi z. E.Sh., ka paraqitur ankesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës duke kërkuar inicimin e procedurës disiplinore ndaj tij si Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës ngase kundërligjshëm kinse ka marrë vendimin e përshtuar më lartë. KGJK tani me vendimin e kontestuar nr. 150/2022 datë 20.4.2022 ka hedhur si të palejuar ankesën e paraqitur nga z. E.Sh., nga Gjilani, kundër vendimit të Kryetarit të Gjykatës Supreme, z. E.P., nr. GJS-2022-005 të datës 24.3.2022, kundër të cilit vendim të KGJK-së z. E.Sh., ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, e cila në këtë rast është objekt shqyrtimi dhe vlerësimi.

Gjykata Supreme, me rastin e shqyrtimit të ligjshmërisë së ankesës së paraqitur nga z. E.Sh., nga Gjilani, gjeti se e njëjta ankesë është e pabazuar, ngase vendimi i kontestuar nuk përfshihet me paligjshmëri dhe parregullsi materiale dhe procedurale. Në ankesë janë paraqitur pothuajse të njëjtat pretendime si në ankesën paraprake, për të cilat KGJK, tani me vendimin e kontestuar, ka dhënë arsye dhe përgjigje të pranuar edhe për Gjykatën Supreme të Kosovës. KGJK me të drejtë në vendimin e kontestuar ka ardhur në përfundim se Ligji i sipërpërmendur për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk i ka dhënë mundësinë ligjore personave fizikë dhe juridikë që të parashtrajnë kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore tek KGJK ndaj autoritetit kompetent si në rastin konkret ndaj Kryetarit të Gjykatës Supreme, kur autoriteti kompetent, si në këtë rast, ka konsumuar shkeljen disiplinore ndaj një gjyqtari në situata të paracaktuara ligjorisht, sepse për këtë veprim është i autorizuar vetëm Avokati i Popullit.

Në nenin 15.3 të Ligjit të sipërpërmendur parashihet që “Në rast se Këshilli nuk merr vendim në përputhje me nenin 14, par. 6, gjyqtari apo prokurori dhe autoriteti kompetent i cili ka kërkuar fillimin e hetimeve si dhe në rastet e parapara me nenin 12 par. 3 të këtij Ligji, Avokati i Popullit mund të ushtrojë ankesë pranë Gjykatës Supreme për mosveprim nga ana e Këshillit përkatës.” Nga kjo dispozitë ligjore rezulton se vetëm Avokatit të Popullit në kuptim

të kësaj dispozite ligjore, në këtë rast, i është lejuar ankesë në Gjykatën Supreme për mosveprim nga ana e KGJK-së. Për këtë arsye, u refuzuan si të pa bazuara pretendimet e ankesës së KGJK në mënyrë të kundërligjshme ka hedhur si të palejuar ankesën e paraqitur nga z. E.Sh., kundër vendimit të Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës Z. E.P., nr.GJS-2022-005, datë 24.3.2022.

Për faktin se me pretendimet e z. E.Sh., të paraqitura në ankesë, assesi nuk vihet në pyetje ligjshmëria e vendimit të kontestuar, në pajtim me nenin 15.6. të Ligjit të sipërpërmendur, ankesa u refuzua si e pabazuar.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

A.A.7/2022 datë 6.6.2022

Kryetari i kolegjit,
Shukri Sylejmani